

do ta braktiste menjëherë shtëpinë, por do të mbetej ta falte *Namazin e Xhumasë* dhe do tu bashkëngjitej të tjerëve më vonë. Ishte kjo hera e fundit që ata e shihnin të gjallë [**Gexhë/Gedža**]. Pas një muaji, më 17.06.1998, kur situata u qetësua pakëz, në fshat u kthyen Isa, djali i Murselit, i cili ishte djali i axhës së Qamilit, si dhe Sanija, vajza e Sadikut, vëllait të Qamilit. U kthyen që të furnizoheshin me ushqime. Në shtëpinë e Qamilit, e gjetën në krevat trupin e tij të pajetë dhe të deformuar. Isa e ka njoftuar menjëherë të atin për gjetjen e tyre. Në të njëjtën mbrëmje, Murseli dhe dy ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur Qamilin në oborr. Atje, ai prehet edhe sot.

Burimi: deklarata S.H, FDH-15494.

Mehedini (Avdullah) Morina

(14.09.1969, shqiptar nga Gllareva/Igllarevo, komuna e Klinës/Klina, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Mehedini ka jetuar dhe punuar në Holandë deri në muajin mars të vitit 1998. Ishte i angazhuar për mbledhjen e parave për fondin *Vendlindja Thërret*. Në muajin mars të vitit 1998, shkoi në Shqipëri për trajnime ushtarake. Në muajin maj të të njëjtit vit, ai hyri në Kosovë, ku aderoi në radhët e UÇK-së. Njësitë e tij vepronte në zonën operative të *Drenicës/Drenica*. Ka rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më **14.05.1998** në fshatin **Gexhë/Gedža**. Një ditë më vonë, e varrosën në varrezat e Gllarevës/Igllarevo.

Burimet: KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 157, FDH-23816; SHFDUÇK, *Feniksët...3*, 57-60; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Ymer (Asllan) Kajdomçaj

(10.04.1930, shqiptar nga Xërxa/Zrze, komuna e Rahovecit/Orahovac, bukëpjekës, nëntë fëmijë)

Ymeri ka qenë bukëpjekës dhe me familjen e vet jetonte në fshatin Xërxë/Zrze. Në datën 12.05.1998, forcat serbe e bombarduan fshatin. Dy ditë më vonë, më **14.05.1998**, kur situata u qetësua përkohësisht, Ymeri u nis për në Ratkoc/Ratkovac që ta vizitonte të bijën Lumturijen. Rrugës e sipër, një njëri

nga Celina e mori Ymerin në qerren me kuaj. Familjarët kanë mësuar më vonë se forcat serbe kishin hapur zjarr mbi Ymerin dhe bashkudhëtarin e tij te vendi i quajtur *Gradish/Gradište*, në mes të **Xërxës/Zrze** dhe Gexhës/Gedža. Ymerin e kanë qëlluar për vdekje në vend. Në mbrëmje, trupin e tij e kanë gjetur ushtarë të UÇK-së dhe e kanë çuar në Ratkoc/Ratkovac. Një ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Ymerin në varrezat e fshatit të Xërxës/Zrze.

Burimet: deklarata L.K, FDH-15509; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 149, FDH-23816.

Imer (Aliriza) Delija

(20.10.1957, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Në muajin maj të vitit 1998, në Rahovec/Orahovac zbatoheshin ashtuquajtura orë policore (orë e mbylljes brenda). Përreth qytetit ishin të stacionuara forcat serbe me armatim të rëndë. Imeri i kishte vreshtat buzë rrugës për Pataçanin e Poshtëm/Donje Potočane. Në datën **18.05.1998**, rreth orës 7:00, ai u nis te vreshtat e vetë [**Rahovec/Orahovac**]. Te shtëpia prisnin që ai të kthehej para fillimit të orës së mbylljes brenda. Ngase nuk u kthye deri në mëngjesin e ditës tjetër, vëllezërit e tij, Kasimi dhe Xhemajli, u nisën për ta kërkuar. E gjetën kufomën e Imerit në anën e djathtë të rrugës për në Pataçan të Poshtëm/Donje Potočane, afro 200 metra larg pikës së karburanteve *Jaha Petrol*. E njoftuan policinë. Familjarët bënë përpjekje që nga shtëpitë e afërta të mësonin çfarë kishte ndodhur, por pa sukses, sepse askush nuk kishte parë apo dëgjuar asgjë. Pas obduksionit, familjarët e kanë varrosur Imerin në varrezat e qytetit.

Burimet: deklarata K.D, FDH-33499; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; AIS, *Zona...*, 57, FDH-16913; FDH, *Rahovec...*, 2, FDH-5698.

Çaush (Muharrem) Krasniqi

(23.09.1959, shqiptar nga Hoça e Vogël/Mala Hoça, komuna e Rahovecit/Orahovac, mësues, tre fëmijë)

Çaushi ka qenë mësues në shkollën *Bajram*